VENDIM
Nr. 158, datë 25.2.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 835, DATË 18.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 18.9.2013, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titullin e vendimit dhe kudo në vendim emërtimi "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes" zëvendësohet me "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes".

2. Kreu II ndryshohet, si më poshtë vijon:

"II. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes përgatit dhe zbaton politikat e qeverisë në sferën ekonomike, të turizmit, të tregtisë dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, me synim rritjen ekonomike, të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri. Ajo harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësorë të ekonomisë, turizmit, konvergjimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës dhe shërbimeve për biznesin dhe sipërmarrjen.".

3. Pas pikës 34, të kreut III, shtohen pikat 35, 36, 37, 38, 39 dhe 40, si më poshtë vijon:

"35. Të hartojë dhe të zbatojë politika për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet nxitjes së investimeve në fushën e turizmit, ngritjes dhe monitorimit të sistemit të standardeve në turizëm dhe edukimit në vazhdim të biznesit në fushën e turizmit, promovimit të produktit dhe destinacioneve turistike, koordinimit dhe bashkëpunimit me strukturat shtetërore, pushtetin vendor, dhe funksione të tjera, të cilat do të mbulohen nga institucionet e varësisë, aparati i ministrisë dhe degët territoriale.

36. Të kontrollojë ndryshimet e regjimit tregtar mbi eksport-importet.

37. Të ndjekë në vazhdimësi procesin e krijimit dhe monitorimit të zonave ekonomike.

38. Të sigurojë në kohë dhe në mënyrë profesionale informacionet e nevojshme dhe të kërkuara lidhur me zbatimin e politikave dhe objektivave të sektorit; të kontribuojë dhe monitorojë në bashkëpunimin edhe me institucionet e tjera për realizimin e kushteve të domosdoshme infrastrukturore për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike.

39. Mbulimi i çështjeve të standardizimit të shpronësimeve është emergjencë dhe domosdoshmëri, për shkak të përfshirjes edhe të zonave ekonomike dhe detyrimit për zbatimin e legjislacionit për këto zona, si dhe të unifikimit të trajtimit të praktikave dhe zgjidhjes së problemeve që dalin gjatë implementimit të projekteve në zbatim.

40. Verifikimi i efiçencës së përdorimit të burimeve ekonomike, që nga trajtimi i tyre nga autoritetet kontraktuese deri në pagesën e detyrimeve që dalin nga procesi i shpronësimit.".

4. Pas pikës 8, të kreut V, shtohen pikat 9 dhe 10, si më poshtë vijon:

"9. Agjencinë Kombëtare të Turizmit (AKT);

10. Inspektoratin e Mbikëqyrjes në fushën e turizmit.".

5. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama